

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/19), ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi

**RREGULLORE**  
**për formën dhe përmbajtjen e planit personal për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme**

Neni 1

Kjo rregullore rregullon formën dhe përmbajtjen e planit personal për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme (në tekstin e mëtejme: plani personal).

Neni 2

Plani personal realizohet në formularin e dhënë në aneksin 1 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Formulari nga paragrafi 1 i këtij neni përbëhet nga tri pjesë: Planifikimi i zhvillimit profesional, Realizimi i zhvillimit profesional dhe Vëzhgimet dhe rekomandimi për realizimin e planit personal.

Neni 3

Seksioni i Planifikimit të Zhvillimit Profesional plotësohet nga mësuesi ose bashkëpunëtori profesional çdo vit shkollor dhe i dorëzohet ekipit të zhvillimit profesional në shkollë deri më 10 shtator për vitin aktual shkollor, në formë letre ose elektronike.

Neni 4

Kjo rregullore rregullon formën dhe përmbajtjen e planit personal për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme (në tekstin e mëtejme: plani personal).

Neni 5

Seksioni- Realizimi i zhvillimit profesional përbëhet nga shtatë kolona: koha e realizimit, zbatimi i asaj që është mësuar, ndikimi te studentët, dëshmitë, arsyet e mosrealizimit, propozimi për aktivitete dhe vërejtjet.

Neni 6

Seksioni -Vëzhgime dhe rekomandime për zbatimin e planit personal përbëhet nga tre kolona: plotësisht i realizuar, pjesërisht e realizuar dhe e porealizuar dhe plotësohet nga ekipi i zhvillimit profesional dhe i dorëzohet drejtorit të shkollës.

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e miratimit dhe do të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2020/21.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës,  
Arbër Ademi nënshkrimi me d.v.

PLANI PERSONAL PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE DHE BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL NË SHKOLLA FILLORE DHE TË MESME

<b>Pjesa 1: PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL</b>			
Shkolla		Vendi dhe komuna	
Mësimdhënës/Bashkëpunëtor profesional		Mësimi klasor/lënda mësimore/Profili i bashkëpunëtorit profesional	
Viti shkollor		Data e përpilimit	

Nr. rend	Kompetencat	Aktivitetet	Resurset	Koha e realizimit	Rezultatet e pritura	Vërejtjet
1.						
2.						
3.						

Lejoi:

Drejtori i shkollës

Nënshkrimi i mësimdhënësit \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Pjesa 2: REALIZIMI I PLANIT PERSONAL PËR ZHVILLIM PROFESIONAL**

	KOMPETENCË	KOMPETENCË	KOMPETENCË
KOHA E REALIZIMIT			
ZBATIMI I TË MËSUARËS			
NDIKIMI TE NXËNËSIT			
DËSHMITË			
ARSYET PËR MOSREALIZIM			
PROPOZIMI I AKTIVITETEVE PËR VITIN VIJUES SHKOLLOR			
VËREJTJET			

**Pjesa 3: VËZHGIMET DHE REKOMANDIMET PËR REALIZIMIN E PLANIT PERSONAL**

<b>SHËNO (√)</b>		<b>ARSYETO</b>	
<b>Plotësisht i realizuar</b>		Cikël i ri për zhvillimin profesional	
<b>Pjesërisht i realizuar</b>		Arsyet për mosrealizim:	
<b>I porealizuar</b>		Zhvillimi profesional i mbështetur:	

Data: \_\_\_\_\_

Mësimdhënës/ Bashkëpunëtor profesional: \_\_\_\_\_

Kryetar i ekipit për zhvillim profesional: \_\_\_\_\_